# SYLLABUS I LËNDËS “ E DREJTA KONTRAKTORE”

| **Të dhëna bazike të lëndës** | |
|---|---|
| **Njësia akademike:** | **Fakulteti Juridik** |
| **Titulli i lëndës:** | **E Drejta Kontraktore** |
| **Programi:** | **Juridik i përgjithshëm** |
| **Niveli:** | **Bachelor** |
| **Statusi lëndës:** | **Obligative** |
| **Viti i studimeve:** | **II** |
| **Numri i orëve në javë:** | **2+1** |
| **Vlera në kredi – ECTS:** | **4** |
| **Koha / lokacioni:** | **Koha/lokacioni (termini i mbajtjes së ligjëratës dhe salla), si dhe detaje të tjera do te caktohen në bashkëpunim me Fakultetin.** |
| **Mësimdhënësi i lëndës:** | **Prof. Asoc. Dr. Berat Aqifi** |
| **Të dhënat kontaktuese:** | **e-mail: berat.aqifi@uni-prizren.com** |
| | |
| **Përshkrimi i lëndës:** | Kontrata si burim kryesor dhe më i rëndësishëm i marrëdhënieve të detyrimeve që paraqet marrëveshje e dy a më shumë personave, që ka për qëllim të krijojë, të ndryshojë, ose të shuajë një marrëdhënie juridike të detyrimit.<br>Kontratat hyjnë në grupin e punëve juridike të dyanshmeqë krijohet detyrimi i ri, ndryshohet marrëdhënia ekzistuese e detyrimit, përkatësisht me anën e saj shuhen detyrimet. Më të rëndësishme janë kontratat me të cilat krijohen detyrimet.<br>Kontrata është instrument juridik, me të cilin krijohen detyrime me vullnetin e palëve kontraktuese.<br>Me anë të kontratës rregullohen marrëdhëniet e pjesëmarrësve në qarkullimin e mallrave dhe me dhënien e shërbimeve.<br>Me anë të saj bëhet, si qarkullimi i brendshëm, ashtu edhe ai ndërkombëtar i mallrave. Kontrata konsiderohet si katëgori juridike më dinamike dhe më elastike. |
| | |
| **Qëllimi i lëndës:** | Kursi synon të ofrojë për studentët informacion të mjaftueshëm në lidhje me te drejten e kontratave dhe që të aplikojnë në praktikë aftësitë e marra nga fushën e se drejtes se kontratave.<br>Qysh se kjo e drejte është e mbuluar nga ky kurs duhet të konsiderohet si një nga subjektet më të rëndësishme të ligjit i cili prodhon ndikim direkt në tregun e lirë, lëvizjen e mallrave dhe shërbimeve,<br>Kursi ka për qëllim që të mundësoji studentëve të kuptojnëmë lehtë normat ligjore të së drejtes së kontratave dhe të aplikojnë njëjten në praktikë.<br>Ligjëratat do të ofrohen duke respektuar format e avancuara për mësimdhënie përmes formës interaktive, e cila |

| | |
|---|---|
| | prezumon aktivitet si nga ana e mësimdhënësit ashtu edhe të studentëve.<br>Ofrimi i shembujve nga praktika gjyqësore do të ketë për qëllim arritjen e shkallës së aftësimit të studentëve për përpilimin dhe interpretimin e kontratave dhe krijimin e opinionit ligjor.<br>Aspektet komparative nga të drejtat e vendeve të tjera do të ofrohen vetëm në rastet e nevojshme për të plotësuar zbrazëtitë teorike të së drejtës në Kosovë dhe për të avancuar njohuritë juridike.<br>Në këtë kuptim, studentët do të aftësohen që të jenë në gjendje për të krijuar opinionin juridik lidhur me një çështje dhe për të arritur te një konkluzion, i cili ka bazën ligjore dhe nuk bie ndesh me legjislacionin në fuqi. Theks të veçantë do t´i kushtohet aftësimit për analizë juridike në bazë të argumenteve. |
| | |
| **Rezultatet e të nxënit**: | Pas perfundimit me sukses te provimit, studentët nga kjo lëndë do të përfitojnë :<br>• Kuptojnë normat ligjore të zbatueshme për kontratat ;<br>• Të jenë në gjendje të aplikojnë dhe të interpretuar normat ligjore të zbatueshme për kontratat ;<br>• Të jenë në gjendje të hartojnë format e kontratave , projekt pushtetin e avokatëve , si dhe formave të tjera ligjore ;<br>• njohuri teorike mbi konceptet e të Procedurave jokontestimore dhe Përmbaruese<br>• njohuri praktike mbi hulumtimin, analizimin dhe zbatimin e Legjislacionit vendor në fushën e të drejtës kontraktuese;<br>• aftësi që të përpilojnë opinione ligjore ne qështjet kontraktuale; |

| **Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)** | | | |
|---|---|---|---|
| **Aktiviteti** | **Orë** | **Ditë/javë** | **Gjithsej** |
| Ligjërata | 2 | 15 | 30 |
| Ushtrime teorike/laboratorike | 1 | 15 | 15 |
| Punë praktike | 1 | 15 | 15 |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | 2 | 5 | 10 |
| Ushtrime në terren | 2 | 5 | 10 |
| Kollokfiume, seminare | 2 | 5 | 10 |
| Detyra të shtëpisë | 2 | 5 | 10 |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 3 | 10 | 30 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Përgatitja përfundimtare për provim | 2 | 10 | 20 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuis,provim final) | 2 | 5 | 10 |
| Projektet, prezantimet ,etj | 2 | 5 | 10 |
| **Totali** | | | **160. orë (4 ECTS)** |
| **Metodologjia e mësimdhënies:** | Leksionet interaktive - studentet përveç ligjëratave, në procesin e ligjërimit do të jenë të angazhuar në mënyrë aktive përmes prezantimeve, diskutime ose debate në lidhje me çështjet e diskutuara gjatë ligjëratave;<br>- Puna seminarike : studentëve do të u shpërndahen temat të cilat do të jenë të nevojshme për të përfunduar punën seminar. Informacion i mjaftueshëm për realizimin e kësaj detyre do të jetë në dispozicion për studentët.<br>Puna seminarike, pas përfundimit, duhet të i dorëzohet profesorit , i cili do të vlerësojë punën seminarike dhe në përputhje diskutojnë temën me studentët.<br>- Punë praktike - Temat e diskutuara gjatë leksioneve janë për t'u konsideruar dhe diskutuar praktikisht me asistentë mësimor. Diskutimi do të përfshijë pjesëmarrjen aktive të studentëve.<br>Në kuadër të programit të lëndës, metodë kryesore e vlerësimit mund të jetë:<br>☐ Përpilimi i kontratave<br>☐ Prania në ligjërata krahasuese;<br>☐ Konsultime;<br>☐ Ushtrime të realizuara me sukses;<br>☐ Testi me shkrim-me gojë;<br>☐ Punë praktike e realizuar;<br>☐ Punimet seminarike;<br>☐ Punë në terren;<br>Projekte të realizuara në punëtorit edukative ; | | |
| **Metodologjia e vlerësimit:** | Kollokium dhe provim final.<br>☐ Vlerësimi i parë: 30%<br>☐ Vlerësimi i dytë 25%<br>☐ Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 10%<br>☐ Vijimi i rregullt 5%<br>☐ Provimi final 30%<br>☐ Total 100%<br>Vlerat e pikëve:<br>Provimi ka 100 pikë.<br>50-60 = 6; 61-70 = 7; 71-80 = 8; 81-90= 9; 91-100 = 10<br>Pikët nën 50 nuk mbërrijnë notën kaluese. | | |
| **Literatura** | | | |

| | |
|---|---|
| **Literatura primare:** | Nerxhivane Dauti, E drejta kontraktuese, Prishtinë, 2003;<br>Nerxhivane Dauti, E drejta detyrimore, 2004;<br>Nerxhivane Dauti, Kontratat, 2012;<br>- Berat A. Formularë të kontratave, Ligjërata të autorizuara;<br>Ligje:<br>Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, 2012 LMD. |
| **Literatura shtesë:** | Literatura ndihmëse:<br>Dr. Sc. Nerxhivane Dauti, E drejta e detyrimeve (pjesa e posaçme, Prishtinë, 2014; |

| **Plani i dizajnuar i mësimit:** | | |
|---|---|---|
| **Java** | **Ligjërata** | **Ushtrime** |
| *Java e parë:* | Hyrje në të drejtën kontraktuese; | Elaborim i lëndës, hyrje në të drejtën kontraktuese; |
| *Java e dytë:* | Kontratat ( informatat e përgjithshme për kursin);<br>Klasifikimi i kontratave; | Diskutime rreth kontratës, informata të përgjithshme. |
| *Java e tretë:* | Kushtet për lidhjen e kontratave | Rast praktik bazuar në njësin mësimore kushtet për lidhjen e kontratës. |
| *Java e katërt:* | Mjetet e sigurimit të kontratave | Diskutim përmes rastit praktik, lidhur me njësin mësimore: mjetet e sigurimit të egzekutimit të kontratës |
| *Java e pestë:* | Kontratat e veçanta të shitjes:<br>Shitje me mostër ose model;<br>Shitje me specifikimet;<br>Rendi për të shitur;<br>Blerje gjyqësore (ankand); | Diskutime rreth njësis mësimore Kontratat e veçanta të shitjes; |
| *Java e gjashtë:* | Kontratat mbi dërgesat e njëpasnjëshme;<br>Kontratat e rastit ( kuturu ) të shitjes; | Diskutim përmes rastit praktik, lidhur me |

| | | |
|---|---|---|
| | Këstet e kontratës së shitjes;<br>Kontrata e shitjes para- pagesa;<br>Kontrata e shitjes me të drejtën për të para- blerë mallrat e shitura;<br>**Kontrata e këmbimit**; | kontratat mbi dëregsat e njëpasnjëshme; |
| *Java e shtatë:* | Kollëkfiumi I | Përsëritje e lëndës |
| *Java e tetë:* | Dhuratë – Kontrata e dhurimit;<br>Përkufizimi;<br>Kushtet;<br>Karakteristikat;<br>Efektet juridike;<br>Përfundimi;<br>**Grupim i kontratës së dhuratës;** | Rast Praktik lidhur me Kontratën për dhurimin, përkufizimi, kushtet, karakteristikat. |
| *Java e nëntë:* | **Kontrata për qiranë;**<br>Përkufizimi;<br>Kushtet;<br>Karakteristikat;<br>Efektet juridike;<br>Përfundimi; | Diskutim përmes rastit praktik lidhur me kontratën për qiranë. |
| *Java e dhjetë:* | **Kontrata për dhënien me qira të lokaleve afariste;**<br>Përkufizimi;<br>Kushtet;<br>Karakteristikat;<br>Efektet juridike;<br>Përfundimi; | Trajtim lidhur me kontratat për dhënien me qira të lokaleve afariste; |
| *Java e njëmbëdhjetë:* | **Kontrata e kredisë;**<br>**Kontrata për transferimin për përdorimin e mallrave;**<br>Përkufizimi;<br>Kushtet;<br>Karakteristikat;<br>Efektet juridike;<br>Përfundimi; | Rast praktik, bazuar në kontratat e kredisë, kontrata për transferimin për përdorimin e mallrave; |
| *Java e dymbëdhjetë:* | **Kontrata mbi vepren (puna e autorit);**<br>**Kontrata e autorizimit;**<br>Përkufizimi;<br>kushtet;<br>Karakteristikat;<br>Efektet juridike;<br>Përfundimi; | Diskutim rreth kontratën mbi veprën. |
| *Java e trembëdhjetë:* | **Kontrata e depozitave;**<br>**Kontrata e partneritetit**<br>Përkufizimi;<br>kushtet;<br>Karakteristikat;<br>Efektet juridike; | Rast praktik lidhur me kontratën e depozitës. |

| | | |
|---|---|---|
| | Përfundimi | |
| *Java e katërmbëdhjetë:* | **Kontrata e sigurimit;**<br>**Kontrata për mbajtjen e përjetshme;**<br>Përkufizimi;<br>kushtet;<br>Karakteristikat;<br>Efektet juridike; | Diskutim rreth kontratës së sigurimit. |
| *Java e pesëmbëdhjetë:* | **Kollokuiumi II-të** | Përsëritje të lëndës |

**Politikat akademike dhe kodi i sjelljes**

- Studenti duhet të jetë i ndërgjegjshme dhe të respektojë institucionin dhe rregullat shkollore;
- Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe te jetë i vëmendshëm në orën mësimore;
- Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e kartelës në teste dhe provim;
- Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet ti përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit.